

**Akt Themelimi**  
**i Shoqërisë "Krisel Construction" sh.p.k.**

Sot, me date: 07 / 02 / 2024,

- **Z. Kristian Çelmeta**, shtetas shqiptar, atësia Roland, lindur më 23.04.2001, në Tirane, banues në adresën: Rruga "Faik KONICA", PALLATI KDK, Tiranë, mbajtës i dokumentit kartë identiteti me nr. K10423051U madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;
- **Zj. Selma Halili**, shtetas shqiptar, atësia Adnan, lindur më 04.08.1996, në Tirane, banues në adresën: Rr. Jordan Clligj, Vila 215 Tiranë, mbajtës i dokumentit kartë identiteti me nr. J65804058H, madhore me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kanë vendosur të themelojnë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**Krisel Construction**" Sh.p.k.. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**NENI 1**

**EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është "**Krisel Construction**" sh.p.k.

**NENI 2**

**SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: "**FORTUZAJ Zona Kadastrale nr.3963, Numri i Pasurisë 31/20, Tirane, Shqiperi**"

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

**NENI 3**

**KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

**NENI 4**

**OBJEKTI**

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

**Import-Export Materiale Ndertimi, Punime Gipsi, Tavane te varura, Lyerje me boje, Stukim, Patinim, Punime Elektrike**

Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

**NENI 5**

**KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 100,000 Leke (një qind mije) dhe është i ndarë në 2 kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Kristian Çelmeta**, zotëron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 50,000 Leke pesedhjetë mije) të kapitalit themeltar.

- **Zj. Selma Halili**, zotëron 1 kuotë, me 5% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 50.000Lekë (pesedhjetë mije) të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

#### **NENI 6**

#### **ORGANET E SHOQËRISË**

Drejtimi i Shoqërisë kryhet nëpërmjet organeve të shoqërisë, të cilat janë:

-Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve; -Administratori/ët.

Asambleja e Përgjithshme do të jetë organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. **Z. Roland Çelmeta**, caktohet Administrator i shoqërisë. Kohëzgjatja e mandatit të Administratorit është 5 (pesë) vjet, me të drejtë ri-emërimi.

#### **NENI 7**

#### **LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM**

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

#### **NENI 8**

#### **DISPOZITA FINALE**

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë duke autorizuar Administratorin **Z. Roland Çelmeta**, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

### **ORTAKËT THEMELUES**

**KRISTIAN CELMETA**



**SELMA HALILI**

